



RAPORT MONITORIMI

Dëgjimet publike për hartimin e buxhetit për vitin 2023

Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Graçanicë



Shtator, 2022



Ky raport është realizuar nga EC Ma Ndryshe si pjesë e Aleancës për Qytetari Aktive në kuadër të programit – “Aleanca për Qytetari Aktive dhe Komuna Përgjegjëse, financuar nga Olof Palme International Center mbështetur nga Qeveria e Suedisë.



HYRJJE

Seancat dëgjimore publike janë mekanizma për mbledhjen e informatave të nevojshme për planifikim sa më të saktë dhe për të ngritur cilësinë e punës që duhet të kryhet. Organizimi i seancave të tilla ndikon në përmirësim të transparencës legislative, në shtim të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe në kursim të kohës duke lejuar që një numër i madh i mendimeve për çështje të ndryshme të merret në konsideratë gjatë një periudhe të shkurtër kohore.

Pjesë e dëgjimeve publike që organizohen nga komunat janë edhe dëgjimet buxhetore që për qytetarët janë një mundësi e mirë për të ndikuar në vendimmarrjen lokale.

Në planifikimin e buxhetit të komunës përfshihen një mori e institucioneve sikurse Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe Ministria e Financave dhe institucione të pushtetit lokal si kryetari dhe kuvendi i Komunës. Gjithsesi ndikim të madh në këtë proces e kanë vetë qytetarët, me pjesëmarrjen e të cilëve rritet edhe transparenca buxhetore.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve buxhetore nëpër komuna është që vetë qytetarët t'i përcaktojnë prioritetet, duke bërë vërejtjet dhe plotësime në draft-buxhetin e përgatitur për kornizën afatmesme buxhetore. E gjithë kjo arrihet nga qytetarët të cilët paraqesin kërkesa të cilat duhet të realizohen nga ekzekutivi i komunës.

Dëgjimet buxhetore për vitin 2023 në komunën e Prishtinës, Prizrenit, Pejës dhe Graçanicës janë monitoruar nga organizatat Syri i Visionit, Democracy +, Communication for Social Development dhe EC Ma Ndryshe si pjesë të Aleancës për Qytetari Aktive në kuadër të programit – "Aleanca për Qytetari Aktive dhe Komuna Përgjegjëse".

Në të katër komunat janë organizuar gjithsej 23 dëgjime publike, ku kanë marrë pjesë 765 qytetarë (153 gra dhe 612 burra) nga të cilët janë paraqitur gjithsej 290 kërkesa.

PRISHTINË

Komuna e Prishtinës këtë vit ka organizuar pesë dëgjime buxhetore, të cilat janë mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal.

1. Dëgjimi publik me OJQ-të dhe shoqërinë civile (nga fusha të ndryshme Sportive, Kulturore, Rinisë, dhe ajo Sociale).
2. Dëgjimi publik me drejtorët e arsimit para fillor, fillor dhe të mesëm.
3. Dëgjimi publik me personelin shëndetësor, QKMF dhe QMF.
4. Dëgjimi publik me kryetarët e bashkësive, lagjeve dhe fshatrave.
5. Dëgjimi publik me Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe përfaqësuesit e tyre të lagjes apo më gjerë.



Gjatë këtyre diskutimeve kanë marrë pjesë gjithsej 106 qytetarë nga ta 24 ishin gra dhe 82 burra.

Meqenëse çdo seancë dëgjimore për buxhetin synonte njerëz të profesioneve të ndryshme, ata paraqitën problemet më preokupuese të profesionit të tyre, me të cilat përballen çdo ditë. Qytetarët theksuan mungesën e investimeve në fushat e caktuara, kështu disa nga kërkesat prioritare të tyre janë:



1. INFRASTRUKTURË MË E MIRË RRUGORE
2. TRANSPORT URBAN PËR FSHATRAT
3. NDRIÇIM PUBLIK PËR TË GJITHË
4. INVESTIME NË SHËNDETËSI, NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QENDRAVE SHËNDETËSORE DHE SHTIMI NË NUMËR I PERSONELIT



5. ZGJIDHJA E PROBLEMIT ME KANALIZIM
6. INVESTIME NË SHKOLLA DHE ÇERDHE PUBLIKE
7. ZGJIDHJA E PROBLEMIT ME QENTË ENDACAK

PRIZREN

Komuna e Prizrenit këtë vit ka organizuar nëntë dëgjime buxhetore, të cilat janë mbajtur në shtatë lokacione:

1. Dëgjimi publik në Gjonaj me banorë të rajonit të Hasit.
2. Dëgjimi publik në Vlashnje me banorë të fshatit Hoqë e Qytetit, Jeshkovë, Malësi e Vërnit, Posllisht, Billushë, Vlashnje, Kobaj, Grazhdanik, Atmaxhë dhe Muradem.
3. Dëgjimi publik në Zhur me banorë të shtatit Zhur, Vërmicë, Shkozë dhe Dobrusht.
4. Dëgjimi publik në Reqan me banorë të rajonit të Zhupës.
5. Dëgjimi publik në Korishë me banorë të fshatit Korishë, Malësi e Re, Lubizhdë, Skorrobisht, Gërnqar, Velezhë, Shpenadi dhe Trepeticë.
6. Dëgjimi publik në Piranë me banorë të fshatit Piranë, Zojz, Medvec, Landovicë, Arbanas, Krushë e Vogël dhe Randobravë.
7. Dëgjimi publik në Prizren janë mbajtur tre dëgjime publike për hartimin e buxhetit:
 - 7.1. Dëgjimi Publik për Buxhetim Gjinor,
 - 7.2. Dëgjimi Publik me OJQ-të, Shoqatat e Biznesit, të Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - 7.3. Dëgjimi Publik i Përgjithshëm me qytetarë të Komunës së Prizrenit.

Në këto dëgjime publike dukshëm nga vitet e kaluara ka pasur rritje të pjesëmarrjes qytetare, pasi që krahasuar nga viti i kaluar ku kanë marrë pjesë 130 qytetarë këtë vit është rritur në 350, ku nga ta 67 ishin gra dhe 283 burra. Nga qytetarët janë paraqitur 178 kërkesa të njëjta, nga të cilat sime më prioritet mund të përmendim:



1. FURNIZIMI ME UJË TË PIJES 24/H
2. INFRASTRUKTURË MË E MIRË RRUGORE
3. NDRIÇIM PUBLIK PËR TË GJITHË
4. FUNKSIONALIZIMI I QMF-VE DHE SHËRBIME MË CILËSORE 24/H



5. ZGJIDHJA E PROBLEMIT ME KANALIZIM
6. HAPJA E RRUGËVE FUSHORE DHE MË SHUMË SUBVENCIONE NË BUIQËSI



7. QASJE DHE GJITHËPËRFSHIRJE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR



PEJË

Komuna e Pejës këtë vit ka organizuar katër dëgjime buxhetore, ato janë mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal:

1. Dëgjimi publik me banorët e Bashkësive Lokale të qytetit: Qendër, Kapeshnica, Karagaçi, Sahat Kulla, Jarine, Puhovc, Dardania, Haxhi Zeka, 7 Shtatori, Kristali, Xhemajl Kade, Fidanishte dhe Rrokaqellli.
2. Dëgjimi publik me Klubet Sportive dhe OJQ-të.
3. Dëgjimi publik me banorët e Bashkësive Lokale të të gjitha fshatrave.
4. Dëgjimi publik me grupe të caktuara të interesit.



Gjatë këtyre diskutimeve kanë marrë pjesë gjithsej 115 qytetarë nga ta 25 ishin gra dhe 90 burra, të cilët kanë paraqitur gjithsej 88 kërkesa nga të cilat si me më prioritet mund të përmendim:



1. FURNIZIMI ME UJË TË PIJES 24/H



2. INFRASTRUKTURË MË E MIRË RRUGORE



3. NDRIÇIM PUBLIK PËR TË GJITHË



4. ZGJIDHJA E PROBLEMIT ME KANALIZIM



5. RREGULLIMI I RRJETIT ELEKTRIK



6. RREGULLIMI I KANALEVE TË UJITJESE

7. ZGJIDHJA E PROBLEMIT ME QENTË ENDACAK

GRAČANICA

Komuna e Graçanicës këtë vit ka organizuar shtatë dëgjime buxhetore, të cilat janë mbajtur në këto lokacione:

1. Dëgjimi publik me këshillat lokal, në Sallën e Kuvendit të Komunës,
2. Dëgjimi publik në Ugljare, takim me qytetarë të fshatit Ugljare dhe Batushë
3. Dëgjimi publik Lepinë, takim me qytetarët e fshatrave Lepinë, Radevë, Suvl Do, Skulanevë, Asane dhe Novo Naselje
4. Dëgjimi publik në Donja Gusterica, takim me qytetarët e fshatit Donja Gusterica, Gornja Gusterica, Dobrotin dhe Livadje,
5. Dëgjimi publik në Llapllasellë, takim me qytetarët e fshatit Llapllasellë, Çagllavicë dhe Preocë,
6. Dëgjimi publik me OJQ-të lokale, në Sallën e Kuvendit Komunal
7. Dëgjimi publik me qytetarët e Graçanicës



Gjatë këtyre diskutimeve kanë marrë pjesë gjithsej 194 qytetarë nga ta 37 ishin gra dhe 157 burra, të cilët kanë paraqitur gjithsej 17 kërkesa nga të cilat si me më prioritet mund të përmendim:



1. INFRASTRUKTURË MË E MIRË RRUGORE



2. NDRIÇIM PUBLIK PËR TË GJITHË



3. ZGJIDHJA E PROBLEMIT ME KANALIZIM



4. PASTRIMI I SHTRATIT TË LUMIT DHE RRUGËVE UJORE



5. RREGULLIMI I RRJETIT ELEKTRIK



6. ELEMINIMI I DEPONIVE ILEGALE TË MBETURINAVE



7. ZGJIDHJA E PROBLEMIT ME QENTË ENDACAK

REKOMANDIME

Organizmi i dëgjimeve buxhetore ka për qëllim të marr një pasqyrë të kërkesave dhe projekteve të propozuara nga ana e qytetarëve për buxhetin e komunës së tyre. Buxheti që hartohet çdo vit nga të hyrat e parasë publike, përcakton se çfarë projekte dhe shërbime do t'u ofrohen qytetarëve, andaj duhet të jetë i shpërndarë mirë dhe i konsultuar me qytetarët.

Andaj është e nevojshme që gjatë hartimit të buxhetit në të ardhmen:

Të arrihet pjesëmarrje më e madhe e qytetarëve, posaçërisht të ketë përfshirje gjinore në numër më të lartë. Kjo mund të arrihet përmes informimit më të gjerë jo vetëm përmes ueb faqeve zyrtare të komunave, por të ofrojnë informim më të gjerë të publikut.

Shumica e komunave ekzistuese kanë të hapura faqe në rrjete sociale që menaxhohen nga zyrtarët komunal. Mirëpo, shumica e tyre kanë mungesë të përditësimit të tyre me informata për qytetarët, dhe poashtu janë për momentin të fokusuara vetëm në një platformë (në këtë rast Facebook).

Për të arritur qëllimin e tyre përveç informimit më të gjerë, pjesëmarrja e qytetarëve mund të arrihet edhe me anë të përshtatjes së orarit dhe vendit të diskutimeve publike.

Kërkesat e adresuar nga qytetarët para diskutimeve publike shumë herë nuk listohen në draft buxhet, e kjo qon pastaj drejt uljes së entuziazmit të tyre për të qenë pjesë e këtyre diskutimeve. Prandaj marrja me më shumë seriozitet dhe trajtimi i tyre duke kthyer përgjigje në secilën kërkesë do të rriste besueshmërinë karshi institucioneve nga ana e qytetarëve.

Të ketë gjithëpërfshirja duke punuar në përkthimin i projektit të buxhetit në të gjitha gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe përfshirjen më të madhe të grupeve të marginalizuara.

Mungesa e angazhimit të qytetarëve mund të jetë për shkak të mungesës së paraqitjes së informatave në mënyrë lehtë të kuptueshme. Prandaj, komunat duhet të investojnë në përdorimin e metodave audio dhe vizuele në paraqitjen e informatave.